



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**RAPORT BUXHETOR PËR SITUATËN  
EKONOMIKO-FINANCIARE TË  
KOMUNËS PËR PERIUDHËN  
JANAR-QERSHOR 2015**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**I. Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2015**

Komuna e Prishtinës për vitin 2015 ka një buxhet të miratuar në vlerë prej 62,114,156 Euro. Nga këto mjete, 27,162,809 Euro (apo 43.7%) janë të planifikuara nga të hyrat vetjake, ndërsa pjesa tjetër nga grantet qeveritare (granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi). Për krahasim, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur edhe burimet e financimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës për dy vitet paraprake fiskale, 2014 dhe 2013.

**Tabela 1: Burimet e financimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës**

<b>Burimet e financimit</b>	<b>2015</b>	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Grandi i përgjithshëm	15,772,332	19,820,593	19,820,593
Grandi specifik për arsim	14,476,693	14,902,875	14,972,695
Grandi specifik për shëndetësi	4,702,522	4,401,472	6,820,523
Të hyrat vetjake	27,162,809	24,318,250	21,757,920
Buxheti shtesë për rritje të pagave 25%	-	2,727,303	-
<b>Gjithsej</b>	<b>62,114,156</b>	<b>66,170,493</b>	<b>63,371,731</b>

**Të hyrat vetjake sipas llojit**

Komuna e Prishtinës në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2015 ka arkëtuar gjithsej 8,624,519.41€ të hyra vetjake, apo 31.8% të të hyrave të planifikuara për këtë vit. Shumica e të hyrave në vlerë absolute janë nga taksat për leje ndërtimi dhe nga tatimi në pronën e paluajtshme.

Realizimi i të hyrave është tejkalar sa i përket licencës për biznes (70%), taksës për transakcion në pronë (56%) dhe taksës për shërbime shëndetësore (55%).

Realizimi i të hyrave ka qenë më i dobët kur është fjala te taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje pasi që ende nuk ka filluar arkëtimi për këtë proces, të hyrat nga participimet dhe donacionet (2%), të hyrat nga inspekcioni (2%), të hyrat nga parkingu (13%) si dhe të hyrat nga infrastruktura rrugore (17%).



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Tabela 2: Krahasimi i planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetjake për periudhën janar-qershor, vitet 2014 dhe 2015

Nr	PËRSHKRIMI	2014			2015		
		Planifikimi	Realizimi	%	Planifikimi	Realizimi	%
1	Taksa për leje ndërtimi	13,200,000.00	3,238,075.54	24.53	9,500,000.00	3,173,226.37	33.40
2	Legalizimi i Ndertimeve pa Leje	-	-	-	1,000,000.00	100.00	0.01
3	Tatimi në pronën e paluajtshme	4,600,000.00	2,712,086.63	58.96	6,300,000.00	2,547,497.22	40.44
4	Licenca në biznes	-	42,200.00	-	70,000.00	48,955.00	69.94
5	Taksa për shfrytëzimi i sip. publike	1,450,000.00	262,439.12	18.10	1,500,000.00	515,256.12	34.35
6	Infrastruktur rrugore	-	23,556.57	-	40,000.00	6,652.00	16.63
7	Taksa nga kadastrri dhe gjeodezia	550,000.00	246,999.66	44.91	500,000.00	213,579.24	42.72
8	Taksa për transakcion në pronë	650,000.00	237,250.00	36.50	500,000.00	279,650.00	55.93
9	Të hyra nga inspekcioni	150,000.00	470.00	0.31	30,000.00	630.00	2.10
10	Taksa për certifik.dhe doku.zyrtare	248,250.00	132,750.00	53.47	280,000.00	130,995.00	46.78
11	Taksa për automjete motorrike	500,000.00	262,300.00	52.46	550,000.00	264,520.00	48.09
12	Taksa për shërbime arsimore	1,200,000.00	670,517.50	55.88	1,300,000.00	583,787.60	44.91
13	Taksa për shërbime shëndetësore	250,000.00	116,328.90	46.53	250,000.00	137,949.30	55.18
14	Gjobat në trafik	650,000.00	327,278.00	50.35	600,000.00	195,458.90	32.58
15	Qiraja e banese dhe renta	-	72,748.14	-	150,000.00	45,783.74	30.52
16	Participime / Donacione	400,000.00	3,600.00	0.90	500,000.00	9,390.00	1.88
17	Te hyrat nga Parkingu + Hortikultura	-	125,530.00	-	1,000,000.00	127,442.00	12.74
18	Të hyrat tjera (Konf.Tenderi)	470,000.00	-	-	-	9,408.13	-
19	Shitja e Pasuris	-	2,707.49	-	-	13,928.49	-
20	Agjensioni i pyjeve	-	1,161.50	-	-	-	-
21	Gjobat nga gjykatat	-	270,220.00	-	600,000.00	-	-
22	Shpronsime	-	812,100.00	-	2,492,609.00	320,125.00	12.84
23	Taksa për Arkivin Komunalë	-	-	-	-	185.30	-
TOTAL		24,318,250.00	9,560,319.05	39.31	27,162,609.00	8,624,519.41	31.75
		PREJ 01-01-2014 DERI 30-06-2014			PREJ 01-01-2015 DERI 30-06-2015		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Detyrimet ndaj Komunës së Prishtinës, përkatësisht të hyrat e arkëtueshme janë si në vijim: për tatim në pronën e paluajtshme 36,923,805 Euro<sup>1</sup>, taksa për leje ndërtimi 6,237,789 Euro dhe shpronësimet nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor 7,676,292.55 Euro. Një pjesë e këtyre të hyrave janë realizuar në pjesën e parë të vitit 2015, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme pritet të arkëtohet në pjesën e dytë të vitit 2015, si dhe në vitet tjera në vijim.

**Shpenzimet sipas kategorive ekonomike**

Nga buxheti i vitit 2015 prej 62,114,156 Euro, si dhe nga mjetet e bartura nga viti 2014 prej 17,893,989.26 Euro, Komuna e Prishtinës në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2015 ka shpenzuar gjithsej 31.4% të këtyre mjeteve. Për krahasim, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur edhe shpenzimet e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin paraprak fiskal 2014.

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është në shkallën prej 50.6%, për mallra dhe shërbime prej 50.4%, për shpenzime komunale 50.5%, për subvencione dhe transfere 17.2% dhe shpenzime kapitale 13.7%.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014, komuna e Prishtinës ka realizuar buxhetin e vitit 2015 për 3.2% më shumë.

**Tabela 3: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën janar-qershor për vitet 2014 dhe 2015**

Programi	Buxheti 2014	Bartja-2013	Totali	Shpenzimi	%	Buxheti 2015	Bartja-2014	Totali	Shpenzimi	%
Paga dhe mëditje	22,237,317.00	24,395.00	22,261,712.00	12,298,957	55.25	26,484,260.00	162,049.00	26,646,309.00	13,481,235.87	50.59
Mallra dhe shërbime	10,282,442.00	704,206.00	10,986,648.00	3,180,221	28.95	7,358,545.00	2,043,935.00	9,402,480.00	4,738,112.40	50.39
Shpenzime komunale	1,760,431.00	-	1,760,431.00	824,560	46.84	1,793,000.00	300,000.00	2,093,000.00	1,057,871.93	50.54
Subv. Dhe trans.	1,595,000.00	50,000.00	1,645,000.00	279,545	16.99	2,210,000.00	573,357.00	2,783,357.00	477,668.73	17.16
Investimet kapitale	27,568,000.00	13,833,563.00	41,401,563.00	5,414,053	13.08	24,268,351.00	14,814,648.26	39,082,999.26	5,370,642.64	13.74
Gjithsejt	63,443,190.00	14,612,164.00	78,055,354.00	21,997,336	28.18	62,114,156.00	17,893,989.26	80,008,145.26	25,125,531.57	31.40

<sup>1</sup> Vlera e paraqitur është nga data 31.12.2014 nga pasqyrat financiare për vitin 2014.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina



## II. Pasqyra e investimeve dhe detyrimeve për periudhën janar-qershor 2015

### Investimet kapitale për vitin 2015

Tabela 4: Shpenzimet kapitale nga buxheti i vitit 2015

1.4	SHPENZIMET KAPITALE	755,742	-	-	18,602,609	19,358,351	1,907,733
1.4.1	DREJTORIA E ADMINISTRATËS	-	-	-	400,000	400,000	147,979
	1 Digjitalizimi i shërbimeve dhe proceseve të punës (Prishtina digjitale)	-	-	-	120,000	120,000	62,292
	2 Rregullimi dhe digjitalizimi i arkivave	-	-	-	50,000	50,000	
	3 Renovimi i ndërtesave të administratës komunale	-	-	-	50,000	50,000	
	4 Projektet me bashkëfinancim	-	-	-	180,000	180,000	85,687
1.4.2	DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE	755,742	-	-	7,122,609	7,878,351	668,798
	1 Rikonstruimi i Platos së kurrizit në lagjen Dardania	-	-	-	600,000	600,000	
	2 Ndërtimi i rrugëve në pjesët urbane me infrastrukture përcjellëse	755,742	-	-	1,552,609	2,308,351	345,129
	3 Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse	-	-	-	2,300,000	2,300,000	
	4 Ndërtimi i infrastrukturës - projekte me bashkëfinancim	-	-	-	30,000	30,000	
	5 Rrjeti i kanalizimit në lagjet e reja	-	-	-	100,000	100,000	
	6 Rruga mbi lumin "Mat"	-	-	-	500,000	500,000	
	7 Rruga mbi lumin "Prishtina" Segmenti i dytë ST	-	-	-	800,000	800,000	306,570
	8 Rrethrotullimi Lakrishte - Rrethrotullimi Arbëri	-	-	-	800,000	800,000	
	9 Projekte për zyrën për komunitete dhe kthim	-	-	-	90,000	90,000	
	10 Hartimi i projekteve për infrastrukturë lokale	-	-	-	350,000	350,000	17,100
1.4.3	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE SHPËTIMIT	-	-	-	4,500,000	4,500,000	681,257
	1 Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik	-	-	-	200,000	200,000	54,300
	2 Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve	-	-	-	200,000	200,000	16,409
	3 Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi, dhe pajisje tjera për siguri në komunikacion	-	-	-	120,000	120,000	48,149
	4 dhe shporta	-	-	-	140,000	140,000	
	5 Furnizimi me makineri, pajisje dhe kamion për bartjen e mbeturinave	-	-	-	110,000	110,000	27,950
	6 Rregullimi i vend ndaljeve-kabinave të autobusëve dhe rregullimi i infrastrukturës për transport (hartat informuese)	-	-	-	100,000	100,000	
	7 Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe parqeve të qytetit	-	-	-	700,000	700,000	437,803
	8 Trajtimi i qenve endacak	-	-	-	120,000	120,000	25,179
	9 Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim	-	-	-	120,000	120,000	
	10 Tregu i kombinuar	-	-	-	130,000	130,000	
	11 Programi për zbatimin e banimit në bashkëpronësi	-	-	-	50,000	50,000	
	12 Pastrimi i shtratit të lumenjve dhe i kanalizimit atmosferik nga puseta në puseta	-	-	-	100,000	100,000	33,107
	13 Studim fizibiliteti për koncesion të deponisë për mbetjet ndërtimore	-	-	-	50,000	50,000	
	14 Mbjellja e fidaneve (drunjve) në hapësirat e qytetit dhe parqet	-	-	-	130,000	130,000	38,360
	15 Rregullimi i pompave për furnizim me ujë për ndërtesat kolektive	-	-	-	80,000	80,000	
	16 Renovimi dhe mirëmbajtja e lojërave për fëmijë dhe fushave sportive	-	-	-	30,000	30,000	
	17 Shtyllat antiparking dhe shtyllat lëvizëse (në formë pistoni)	-	-	-	120,000	120,000	
	18 Projekti i Kogjenimit NQ Termokos	-	-	-	1,000,000	1,000,000	
	19 Projekti i ndërtimit të Fabrikës së Ujit në Shkabaj	-	-	-	1,000,000	1,000,000	





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



<b>1.4.4</b>	<b>DREJTORIA E PRONËS</b>	-	-	-	<b>2,700,000</b>	<b>2,700,000</b>	<b>406,722</b>
1	Shpronësimi	-	-	-	2,700,000	2,700,000	406,722
<b>1.4.5</b>	<b>DREJTORIA E KADASTRIT</b>	-	-	-	<b>150,000</b>	<b>150,000</b>	
1	Regjistrimi i katastrit të përcjajve, objekteve nëntokësore	-	-	-	50,000	50,000	
2	Rikonstruimi i informacionit kadastral	-	-	-	50,000	50,000	
3	Ingjizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore	-	-	-	50,000	50,000	
<b>1.4.6</b>	<b>DREJTORIA E KULTURËS</b>	-	-	-	<b>1,050,000</b>	<b>1,050,000</b>	<b>2,976</b>
1	Furnizim me libra	-	-	-	50,000	50,000	
2	Teatri i qytetit	-	-	-	200,000	200,000	
3	Konzerximi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore	-	-	-	400,000	400,000	
4	Restaurimi i objekteve kulturore	-	-	-	100,000	100,000	2,976
5	Organizime dhe manifestime kulturore dhe sportive	-	-	-	150,000	150,000	
6	Dekorimi i qytetit për festa	-	-	-	100,000	100,000	
7	Art në hapësira publike	-	-	-	50,000	50,000	
<b>1.4.7</b>	<b>DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM</b>	-	-	-	<b>2,680,000</b>	<b>2,680,000</b>	
	<b>SEKTORI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK</b>	-	-	-	<b>1,030,000</b>	<b>1,030,000</b>	
	S.P. - Hartimi i Hartës Zonale të Komunës (vizioni, objektivat, strategjitë e intervenimit, etj)	-	-	-	100,000	100,000	
1	S.P. - Hartimi i Planit rregullues të Hollësishëm - Prishtina e Vjetër, Rikualifikim Urban i Zonës historike	-	-	-	150,000	150,000	
2	S.P. - Hartimi i Planit rregullues të Hollësishëm - Lakrisht, Rikualifikim urban i Zonës sportive (Pallati i Rinisë, Stadiumi, Rilindja etj.)	-	-	-	90,000	90,000	
3	S.P. - Faza e dytë e hartimit të Planit rregullues të Hollësishëm Qendra 1 dhe Qendra 2	-	-	-	50,000	50,000	
4	S.P. - Hartimi i Planit rregullues të Hollësishëm Dardania, Ulpiana, Aktash - Rikualifikim i Zonave të banimit	-	-	-	90,000	90,000	
5	S.P. - Revizimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme ekzistuese Mati I, Tophane, Pejton, Vellushë, Muhaxher, etj	-	-	-	90,000	90,000	
6	S.U - Intervenime hapësinore - Harta Zonale Bujqësore për Lugmir, Novosellë, Hajvali, Mramor, Busi, Slivove, Koder, Dragoc, Merion	-	-	-	40,000	40,000	
7	Nishec	-	-	-	40,000	40,000	
8	S.P.U - Intervenime hapësinore - Harta Zonale Bujqësore, Llukar, Rrezane, Bardhosh, Kalaja, Gurkuq, Lebane, Progos, Dren, Barilaj, Dafinet, Kulinë	-	-	-	40,000	40,000	
9	S.P.U - Intervenime hapësinore - Harta Zonale Bujqësore për Makaj, Gijtet, Keqekollë, Prapashticë, Dushkajë, Gjelbistë, Murrizaj	-	-	-	40,000	40,000	
10	S.M. Zhvillimi aktiviteteve të ndryshme sipas kalendarit mjedisor	-	-	-	30,000	30,000	
11	S.M. Fushata vetëdijësuese për efience të energjisë, ndarje të mbeturinave, ruajtje të biodiversitetit, etj	-	-	-	10,000	10,000	
12	S.N. - Hartim i projektit të trafikut për tërë Komunën e Prishtinës	-	-	-	20,000	20,000	
13	S.M. - Projekti Ekzekutiv dhe Implementimi i projektit "Riciklim i mbeturinave"	-	-	-	50,000	50,000	
14	S.S.P. - Publikime-revista-filma-libra të punëve të bëra nga D-UNMM në bashkëpunim me Drejtoritë tjera	-	-	-	10,000	10,000	
15	S.U. - Konkurs i Sallës Koncertuale të Prishtinës (në vend të Objektivit të ATK-së)	-	-	-	90,000	90,000	
16	S.U. - Projektimi për zonën historike - ish qendra e pionierëve	-	-	-	90,000	90,000	
17	<b>SEKTORI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM</b>	-	-	-	<b>250,000</b>	<b>250,000</b>	
18	Projektet me bashkëfinancim dhe promovim	-	-	-	10,000	10,000	
19	Promovimi i bashkëpunimit ekonomik me qytetet tjera nga vende të ndryshme	-	-	-	20,000	20,000	
20	Promovimi i punësimit të të rinjve - trajnime në ndërmarrësi nëpërmjet programit të praktikës	-	-	-	90,000	90,000	
21	Konferenca tematike për zhvillim	-	-	-	20,000	20,000	
22	Përkrahja për zhvillimin e turizmit	-	-	-	20,000	20,000	
23	Krijimi i ndërmarrjeve të reja publike lokale	-	-	-	80,000	80,000	
24	Trajnim për menaxhim të projekteve	-	-	-	10,000	10,000	
	<b>SEKTORI I RINISË DHE SPORTEVE</b>	-	-	-	<b>1,400,000</b>	<b>1,400,000</b>	
25	Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe fushave sportive në komunën e Prishtinës	-	-	-	300,000	300,000	
26	Pishina e mbyllur olimpike	-	-	-	800,000	800,000	
27	Renovim i objekteve sportive	-	-	-	100,000	100,000	
28	Studimi për Pallatin e Rinisë	-	-	-	100,000	100,000	
29	Renovimi dhe rregullimi i hapësirave komunale për nevoja të komunitetit	-	-	-	100,000	100,000	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



II BUXHETI SEKTORIAL - SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE							
II.4	<b>SHPENZIME KAPITALE</b>	-	-	-	<b>1,410,000</b>	<b>1,410,000</b>	20,000
1	Ndërtimi i objektit të QMF Vetemik	-	-	-	230,000	230,000	
2	Ndërtimi i objektit të QMF Tophane	-	-	-	230,000	230,000	
3	Vazhdimi i ndërtimit të qendrës për qëndrim ditor	-	-	-	35,000	35,000	
4	Programi i veçantë i banimit	-	-	-	90,000	90,000	
5	Paisje mjekësore për QKMF dhe QMU	-	-	-	160,000	160,000	20,000
6	Renovime, përmirësim i infrastrukturës së objekteve shëndetësore dhe sociale	-	-	-	160,000	160,000	
7	Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore dhe sociale	-	-	-	60,000	60,000	
8	Dezinsektimi hapësinor	-	-	-	220,000	220,000	
9	Deratizimi vjeshtor i podumeve dhe garazheve	-	-	-	70,000	70,000	
10	Deratizimi i kanalizimit	-	-	-	65,000	65,000	
11	Dezinfektimi dhe Deratizimi i objekteve shëndetësore dhe arsimore	-	-	-	60,000	60,000	
12	Zonimi dhe digjitalizim i institucioneve shëndetësore dhe sociale	-	-	-	30,000	30,000	
III BUXHETI SEKTORIAL - ARSIMI							
III.4	<b>SHPENZIME KAPITALE</b>	-	-	-	<b>3,500,000</b>	<b>3,500,000</b>	<b>30,284</b>
1	Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria	-	-	-	300,000	300,000	
2	Ndërtimi i shkollës në Sofali	-	-	-	250,000	250,000	
3	Ndërtimi i infrastrukturës shkollore (përfundimi i Shkollës së Muzikës, ndërtimi i paraleleve)	-	-	-	250,000	250,000	
4	Ndërtimi i shkollës në lagjen Vetemik	-	-	-	300,000	300,000	
5	Ndërtimi i shkollës në lagjen Mati I	-	-	-	200,000	200,000	
6	Ndërtimi i çerdheve	-	-	-	430,000	430,000	4,320
7	Ndërtimi i sallave sportive për disa shkolla	-	-	-	300,000	300,000	
8	Ndërtimi i terreneve sportive në disa shkolla	-	-	-	100,000	100,000	
9	Rregullimi i oborreve dhe rrethojave të shkollave	-	-	-	100,000	100,000	
10	Vendosja e kamerave të sigurisë	-	-	-	50,000	50,000	
11	Rikonstruktimi dhe gëzqerosja e shkollave	-	-	-	300,000	300,000	6,390
12	Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore	-	-	-	250,000	250,000	4,875
13	Pajisja e disa shkollave me rekuizita sportive	-	-	-	100,000	100,000	
14	Pajisja e disa shkollave me kabinete	-	-	-	200,000	200,000	
15	Furnizimi i bibliotekave shkollore	-	-	-	100,000	100,000	
16	Vendosja e rezervuarve të ujit nëpër shkolla	-	-	-	50,000	50,000	14,699
17	Digjitalizimi i ditarëve	-	-	-	20,000	20,000	
18	Muzeu shkencor për fëmijë	-	-	-	200,000	200,000	

Pasqyra e detajuar e investimeve është e paraqitur si shtojcë e këtij dokumenti.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Tabela 5: Shpenzimet kapitale nga bartja e mjeteve të vitit 2014

Bartja e investimeve kapitale nga viti 2014 ne vitin 2015				Buxheti	Shpenzimet	Mbetja
<b>Administrata komunale</b>				<b>350,000.00</b>	<b>61,389.78</b>	<b>288,610.22</b>
1.1	16306	Paisje kompjuterike dhe softver aplikativ	89345	250,000.00	55,385.78	194,614.22
1.2	16306	Furnizim me inventar sipas nevojave te Ad.Komunale	89346	100,000.00	6,004.00	93,996.00
<b>Buxheti</b>				<b>722,000.00</b>	<b>417,611.00</b>	<b>304,389.00</b>
2.1	17506	Shpronsimi dhe ndertimi I infrastruktures	89347	700,000.00	417,611.00	282,389.00
2.2	17506	Projektete me bashkfinancim	89344	22,000.00	-	22,000.00
<b>Infrastruktura rrugore</b>				<b>8,973,805.78</b>	<b>1,527,732.15</b>	<b>7,446,073.63</b>
3.1	18006	Ndertimi I rrugeve ne pjeset urbane me inf. Percjellese	89350	4,749,839.23	724,541.93	4,025,297.30
3.2	18006	Ndertimi I rrugeve ne pjeset rurale me inf. Percjellese	89351	2,363,019.87	537,720.42	1,825,299.45
3.3	18006	Ndertimi I rruges "B", faza e dyte	82261	200,000.00	-	200,000.00
3.4	18006	Nd.rr.Enver Maloku pjesa 1	87421	1,660,946.68	265,469.80	1,395,476.88
<b>Sherbimet Publike</b>				<b>815,662.75</b>	<b>159,376.96</b>	<b>656,285.79</b>
4.1	18166	Rregullimi I vendeve te kontejnereve dhe furnizimi me kontejner n	87430	33,856.60	21,978.02	11,878.58
4.2	18166	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal I rrugeve	89365	150,157.95	42,869.34	107,288.61
4.3	18166	Rregullimi i parkut te Germisë	87437	80,000.00	-	80,000.00
4.4	18166	Zgjerimi I rrjetit te ndriqimit publik	89363	111,648.20	94,529.60	17,118.60
4.5	18166	Blerja e makinerise dhe paisjeve	85300	350,000.00	-	350,000.00
4.6	18166	Rregullimi I rrethojave dhe pastrimi fitosanitar	I ri	90,000.00	-	90,000.00
<b>Ekonomia</b>				<b>100,000.00</b>	<b>-</b>	<b>100,000.00</b>
5.1	48006	Promovimi i punësimit të rinjëve-trajnimet në ndërmarrësi nepermjet programit te praktikkes intership	89379	100,000.00	-	100,000.00
<b>Kataster</b>				<b>50,000.00</b>	<b>-</b>	<b>50,000.00</b>
6.1	65030	Regjistrimi i kadastrit të perqojave, objekteve nentokësore dhe ka	89382	50,000.00	-	50,000.00
<b>Urbanizmi</b>				<b>700,000.00</b>	<b>15,110.45</b>	<b>684,889.55</b>
7.1	66335	Matjet gjeodezike per revidimin e planeve	I ri	256,000.00	-	256,000.00
7.2	66335	Hartimi I planeve rregulluese dhe revidimi I planeve rregulluese	87455	240,000.00	-	240,000.00
7.3	66335	Hartimi I projekteve kryesore dhe revidimi	87456	204,000.00	15,110.45	188,889.55
<b>Kultra dhe sporti</b>				<b>751,462.44</b>	<b>221,512.88</b>	<b>529,949.56</b>
<b>Kultra</b>				<b>414,470.50</b>	<b>189,992.39</b>	<b>224,478.11</b>
8.1	85006	Inventar dhe paisje per institucione kulturore dhe sportive	89409	166,492.00	65,015.00	101,477.00
8.2	85006	Restaurimi I objekteve kulturore	40432	19,198.00	-	19,198.00
8.3	85086	Pishina e mbyllur	85357	228,780.50	124,977.39	103,803.11
<b>Sporti</b>				<b>336,991.94</b>	<b>31,520.49</b>	<b>305,471.45</b>
9.1	85086	Ndertimi I fushave sportive ne komunene e Prishtines	89412	136,991.94	31,520.49	105,471.45
9.2	85086	Staza e atletikes ne taubashqe, arberi dhe germi	85356	100,000.00	-	100,000.00
9.3	85086	Rekuizita sportive per nevoja te klubeve	I ri	100,000.00	-	100,000.00
<b>Shëndetsia</b>				<b>744,899.43</b>	<b>486,476.25</b>	<b>258,423.18</b>
10.1	73350	Ndertimi I QMF-ve	88901	152,895.01	-	152,895.01
10.2	73350	Ndertimi I objektit banesor per rastet sociale	88903	106,600.30	106,600.30	-
10.3	73350	Furnizim me dy autoambulanca per nevojat e QMU-se	87464	118,960.00	118,960.00	-
10.4	73350	Furnizim me inventar per nevojat e QKMF-se Prishtine	89400	21,076.00	21,076.00	-
10.5	73350	Renov.permirsime infrastr.objektit shëndetsor dhe social	89401	275,988.12	190,459.95	85,528.17
10.6	73350	Paisje mjekësore	89402	69,380.00	49,380.00	20,000.00
<b>Arsimi</b>				<b>1,606,817.86</b>	<b>439,346.00</b>	<b>1,167,471.86</b>
<b>Arsimi parashkollor dhe Çerdhet</b>				<b>44,800.00</b>	<b>346.00</b>	<b>44,454.00</b>
11.1	92310	N dertimi I qerdheve	40441	44,800.00	346.00	44,454.00
<b>Arsimi fillor</b>				<b>1,013,236.51</b>	<b>352,689.33</b>	<b>660,547.18</b>
12.1	93150	Rikonstruimi i sh.f "Elena Gjika"	89417	226,146.50	166,009.50	60,137.00
12.2	93150	Ndertimi i shkolles fillore "Arberia-2"	85371	200,000.00	-	200,000.00
12.3	93150	Rregullimi i rrethojave dhe oborreve te shkoll.	87487	239,143.20	58,973.41	180,169.79
12.4	93150	Ndert. i salles ed. Fizike "Ganimete Terbeshi"	87483	16,877.71	-	16,877.71
12.5	93150	Ndertimi i salles se ed. Fiz. ne Shkendija-hajvali"	89415	181,069.10	127,706.42	53,362.68
12.6	93150	Furnizimi me rekuizita sportive per salla te ed fizike	40447	150,000.00	-	150,000.00
<b>Arsimi I mesem</b>				<b>548,781.35</b>	<b>86,310.67</b>	<b>462,470.68</b>
13.1	94350	Rikonstruimi dhe gelqerosja shkollave	88907	95,926.21	25,037.62	70,888.59
13.2	94350	Paisje për Inventar, kabinete e libra per bibliot.	87488	132,822.53	26,174.54	106,647.99
13.3	94350	Ndertimi i shkolles të muzikes "Prenk Jakova"	89423	100,000.00	6,890.02	93,109.98
13.4	94350	Ndertimi i salles ed. fiz ne ish gjim E Qabej"	49421	220,032.61	28,208.49	191,824.12
<b>Totali</b>				<b>14,814,648.26</b>	<b>3,328,555.47</b>	<b>11,486,092.79</b>





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



### **Detyrimet e komunës së Prishtinës**

Zyra e përfaqësimit juridik për periudhën janar deri me 31 mars 2015.

Zyra e përfaqësimit juridik, deri më tani ka gjithsej 173 lëndë prej dt. 01.01.2015 deri më dt. 31.03.2015, të natyrave të ndryshme ( pronësore, administrative, banesore penale, kompensim dëmi, borxhe etj ).

Prej këtyre lëndëve 24 janë me vlera monetare të caktuara në padi ose në ekspertiza e të cilat lëndë janë në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me përjashtim të lëndës III. C. nr. 737/2013, e cila është sipas ankesës së paditësit dhe komunës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Këto janë lëndët:

1. **“ Global & Standard”**, kompensim dëmi, III. C. nr. 737/2013, vlera monetare sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike, është 200,077.73 €, si dhe shpenzimet gjyqësore 414. Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në vlerën prej 296,393,07 €, e që është në dobi të komunës kjo pjesë e Aktgjykimit;
2. **Faik Azemi**, kontest pune, C. nr. 1816/2009, lënda është prishur me revizion dhe është në rigjykim në shkallën e parë, kontest pune vlera në ekspertizën e mëparshme është 9,486.08 €;
3. **Llaziq Vlladimir**, C. nr. 1763/2014, kompensim dëmi, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore Prishtinë, objektet e rrënuara mbrapa qeverisë në vitin 2017, afër kryqit të kuq komunal. Vlera sipas ekspertizës 43,479.20 €;
4. **Pllanka Gigiq**, N. nr. 332/2006, kompensim real, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera monetare 2.000.000 €, sipas ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë për 4 hektar të kthyera paditëses sipas vendimit të komisionit për kthimin e tokave nga ana e komunës së Prishtinës, gjatë vitit 1997, si dhe vendimet gjyqësore të para luftës të plotfuqishme;
5. **Shaip Mustafa**, kompensim dëmi, vlera sipas padisë 15.000 €, ku të paditur janë Eskavatori, Ujësjiellësi Rajonal Prishtina, komuna e Prishtinës, që ndërlidhe me ndërtimin e rrugës “ Haxhi Zeka “, lënda në procedurë në shkallën e parë;
6. **Shabi Dermaku**, kompensim dëmi, C. nr. 1326/2006, ku të paditur ka edhe subjekte tjerë privat si dhe komuna e Prishtinës, lënda në procedurë në shkallë të parë, vlera e dëmit sipas padisë, 200.000 €;
7. **Liljana Petroviq**, kompensim dëmi, C. nr. 2393/2009, ku vlera sipas padisë është 33.000 €, dhe ende është në procedurë;



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



8. **Gazeta “ Tribuna Shqiptare “**, C. nr. 1017/2013, borxh, vlera 464 €, dhe ende është në procedurë, Gazetat të cilat i ka marrë Komuna, dhe paditësi pretendon se nuk janë paguar;
9. **Qoliq Ugljesha**, kompensim dëmi, C. nr. 524/2009, ku vlera sipas padisë është 225.000,00 €. Lënda ka të bëjë me ndërtimin e rrugës trasenë e së cilës e ka hapur Kfori Suedez, ndërsa projektin e asfaltimit të sajë e ka bërë komuna, sipas kontratës nr. 61613147521, dt. 04.10.2013;
10. **Sharac Vidosava**, kompensim dëmi, C. nr. 530/2014, vlera sipas padisë 80.000 €, lënda që lidhet me dëmet e luftës të vitit 1999, lënda është ende në procedurë në shkallën e parë;
11. **Ilir Fuga**, kompensim dëmi, C. nr. 2736/2013, lënda e kthyer në rigjykim në shkallën e parë, vlerat sipas ekspertizës për tokë 72,372.00 €, dhe 120,595 €, për shtëpi. Lënda ka të bëjë me ndërtimin e rreth rrotullimit në lagjen “ Arbëria “;
12. **Vujaqiq Veljko**, kompensim dëmi, C. nr. 537/2004, lënda në procedurë në gjykatën e shkallës së parë, vlera sipas padisë 65.000 €;
13. **“ Atele Artitektura “**, kompensim dëmi, C. nr. 425/2013, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shuma sipas padisë 20.000.00 €;
14. **Besim Firza**, kompensim dëmi, C. nr. 2833/2009, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku komuna është e paditura e tretë, vler sipas ekspertizës 2.820.80 €;
15. **Gani dhe Remzi Haziri**, kompensim dëmi, C. nr. 2430/2010, të paditura NN. “ Fatlindi “ dhe komuna e Prishtinës, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 30.000 €;
16. **Emrush Gashi**, kompensim i tokës C. nr. 2675/2012, e paditur komuna e Prishtinës, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 40.000 €;
17. **Mandushe Hasani**, kompensim i pagave të pensionit, C. nr. 2796/2012, e paditur komuna e Prishtinës, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 1.336 €;
18. **Sanije Sheremeti**, kompensim i pagave të pensionit, C. nr. 915/2011, e paditur komuna e Prishtinës, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 299 €;
19. **Zijadin Tahiri**, kontest pune C. nr. 3100/2013, e paditur Komuna e Prishtinës, lënda e kthyer në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në rishqyrtim me Aktgjykim të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, vlera sipas Aktgjykimit të mëparshëm C. nr. 494/2007, 14.271.90 €, si dhe shpenzimet gjyqësore 633 €;



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



20. **Mexhit Kajtazi**, kompensim dëmi, C. nr. 232/2011, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kontesti për lokalet te nënkalimi vlera sipas padisë 30.000 €, si dhe 4.000 €, për çdo muaj prej prishjes së lokaleve;
21. **Hasanali Hetemi**, kompensim dëmi, C. nr. 142/2006, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kontesti për lokalet te nënkalimi vlera sipas padisë 18.000 €;
22. **Faik Azemi**, kontest pune - Drejtoria për Arsim, C. nr. 1481/2011, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 120.000.00 €;
23. **Sahit Muqolli**, kompensim i pagave për pension, C. nr. 7/2013, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 552 €;
24. **Ragip Selmani**, kompensim i pagave për pension, Drejtoria e Shëndetësisë, C. nr. 97/2015, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 1995 €;
25. **Gjorgjeviq Trajko**, kompensim dëmi, C. nr. 1688/2004, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera sipas padisë 90.000.00 €;

Komuna e Prishtinës, me padi ndaj Firmës “ Noti “, ka kërkuar vlerën monetare 18.990.52 €.

*Në procedurën përmbarese është lënda e Rexhep Beqirit, PPP. nr. 15/2014, e cila është me ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, vlera monetare sipas Aktgjykimit C. nr. 2712/2012, vlera për ngastrën e shpronësuar nr. 681-1, shumën prej 98.400 €, për pjesën e ngastrës nr. 682-1, shumën prej 179.780 €, dhe kumatën prej 7 %, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 573 €.*

Zyra e përfaqësimit juridik për periudhën Prill, Maj, Qershor, për vitin 2015.

Zyra e përfaqësimit juridik, deri më tani ka gjithsej 149 lëndë prej dt. 01.04.2015 deri më dt. 30.06.2015, të natyrave të ndryshme ( pronësore, administrative, banesore penale, kompensim dëmi, borxhe etj ).

Prej këtyre lëndëve 2 lëndë janë me vlera monetare të caktuara në padi, një lëndë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e që është në fazën e ankimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, dhe një në procedurën përmbarese.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



1. **C. nr. 2672/2009**, kompensim i pronës së shpronësuar, sipas padisë së paditësit, vlera 15.000 €, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë;
2. **C. nr. 1959/2015**, kontest pune, lënda në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vlera 3.342.50 €;
3. **C. nr. 1180/2010**, kontest pune, Grupi i Punëtorëve të Administratës së Komunës, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vlera 112.401.75 €, si dhe shpenzimet e procedurës 2284 €, me ankesë nga Komuna e Prishtinës, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë;

***Përmbartimore.***

4. **P. nr. 657/2015**, Pagesë Borxhi, lënda në procedurën përmbartimore, vlera 89.760,00 €, me ankesë nga ana e Komunës së Prishtinës, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, si dhe shpenzimet e procedurës 822.00 €.